



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:021315

Datë: 23.10.2024

Numri i dokumentit: 06337334

Ac.nr.6250/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Nehat Idrizi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve K.K, L.K, S.K, S.K dhe M.B, që të gjithë nga V....., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson L.T, avokat nga P....., kundër të paditurës Komuna e V....., të cilën e përfaqëson E.S, avokat nga V....., lidhur me çështjen juridike kontestimore kompensim i pagave për shpërblim jubilar dhe ushqimit – shujtave për ditët e pranisë në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.1007/2021, i datës 03.08.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 22.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.1007/2021, i datës 03.08.2022, pjesërisht në pikën I të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë së paditësve K.K dhe L.K përkitazi me kompensimin e shpërblimit jubilar, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim: REFUZHET e pa themeltë kërkesëpadija e paditësve K.K dhe L.K, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Vushtrrisë, që paditësve, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të pagës bazë t’iu kompensojë shumën prej 224.49 Euro për secilin prej tyre.

II. REFUZHET pjesërisht e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e V....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.1007/2021, i datës 03.08.2022, pjesërisht në pikën I dhe II të dispozitivit në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë për shpërblim jubilar për paditësin M.B dhe për shujtat ditore për secilin paditës, për kamatën e gjykuar, si dhe në pikën II të dispozitivit për shpenzimet e procedurës kontestimore, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1007/2021, i datës 03.08.2022, ka vendosur si në vijim: “ *I.APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësve K.K, L.K dhe M.B, të gjithë nga V....., kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë me të cilën kanë kërkuar kompenzimin e shujtave për ditët e pranisë në punë dhe shpërblimit jubilar, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e V..... që:*

*1. Paditësit K.K, në emër të shpërblimit jubilar për dhjetë (10) vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë, t'i kompensoj shumën prej 224.49€ si dhe në emër të kompensimit të shujtave për 441 ditë të pranisë në punë (shujtave ditore), ( nga dy (2) euro për secilën ditë të prezencës në punë), për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e gjërë me datën 16.06.2019, shumën prej 822 € apo shumën e përgjithshme prej 1,046.49 €.*

*2. Paditësit L.K në emër të shpërblimit jubilar për dhjetë (10) vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë, t'i kompensoj shumën prej 224,49€ si dhe në emër të kompensimit të shujtave për 441 ditë të pranisë në punë (shujtave ditore), ( nga dy (2) euro për secilën ditë të prezencës në punë), për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e gjërë me datën 16.06.2019, shumën prej 822 € apo shumën e përgjithshme prej 1,046.49 € dhe*

*3. Paditësit M.B në emër të shpërblimit jubilar për mbi ( 20 ) vite të përvojës së punës, në vlerë të 75% të një page bazë, t'i kompensoj shumën prej 349,40 € si dhe në emër të kompensimit të shujtave për 441 ditë të pranisë në punë (shujtave ditore), ( nga dy (2) euro për secilën ditë të prezencës në punë), për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e gjërë me datën 16.06.2019, shumën prej 822 € apo shumën e përgjithshme prej 1,171.40€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, e cila llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë me datën 23.10.2019, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 748,80 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.*

*II.OBLIGOHEN paditësit K.K, L.K, S.K, S.K dhe M.B, që në mënyrë solidare në emër të taksës për paraqitjen e padisë, në këtë gjykatë, të paguajnë shumën prej 60 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm”.*

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë si të bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ashtu që të vendosë në mënyrë meritore ose që të prishet aktgjykimi dhe lënda të kthehet në rishqyrtim organit të shkallës së parë.

Ankesa e të paditurës i është dorëzuar paditësve, por të njëjtit nuk kanë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, kanë ushtruar padi ndaj të paditurës me datën 23.10.2019 kanë paraqitur padi kundër të paditurës lidhur me çështjen juridike kompensim i pagave për shpërblim jubilar dhe ushqimit – shujtave për ditët e pranisë në punë, duke theksuar se të njëjtit janë në marrëdhënie pune tek e paditura Komuna e V....., konkretisht në institucionin arsimor Sh.F.M.U “D.....” në fshatin Zh....., Komuna e V..... duke shtuar se që nga hyrja në fuqi e Kontratës Kolektive dt.18.04.2017 paditësit nuk janë kompensuar me nga dy (2) euro për secilën ditë të pranisë në punë dhe se sipas kalendarit shkollor të filluar nga dt.18.04.2017 e deri në përfundim të vitit shkollor 2018/2019 kanë gjithsej 411 ditë pranie në punë, apo në shumën e përgjithshme prej 822 € për secilin paditës, ndërsa që baza për këtë kompensim të shujtës ditore rrjedhë nga neni 35 par 7 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Po ashtu, neni 35, par.8 i kësaj kontrate përcakton se punëtorët në vitet jubilarë të punësimit fitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi, ashtu që paditësit K.K dhe L.K kanë përvojë pune mbi 11 vjeçare, të njëjtëve të ju paguhet shuma prej 224,49 € në emër të shpërblimit jubilar, ndërsa paditësi M.B ka përvojë punë mbi 21 vjeçare, t’i paguhet shuma prej 349,39 €, duke kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që të obligoj të paditurën të përmbush detyrimin e saj ndaj paditësve, me kamatë ligjore nga dita e ushtrimit të padisë, e deri në përmbushjen definitive të tyre, gjithashtu kanë kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave në shkresa të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.709/19, i datës 12.02.2020, me të cilin në tërësi e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë si të bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin i atakuar të anulohet ose që çështja të kthehet në rivendosje dhe rigjykim. Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësve duke i vlerësuar si të pabazuara pretendimet ankimore të të paditurës, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet e pabazuar ndërsa aktgjykimin i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit duke vepruar sipas kësaj ankesë ka nxjerrë aktvendimin Ac.nr.1882/20 të datës 12.07.2021, duke e aprovuar ankesën e të paditurës si të themeltë ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka prishur me rekomandimin që të analizohet kompetenca lëndore për sa i përket paditësve S. dhe S.K pasi që këta paditës janë shërbyes civil si dhe vërtetimi i përvojës së punës së secilit paditës tek e paditura.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas sugjerimeve të lartcekura të gjykatës së shkallës së dytë jashtë seancës ka nxjerrë aktvendimin e datës 01.08.2022, është shpallur inkompetente në aspektin lëndor për të gjykuar kërkesat e paditësve S.K dhe S.K duke ia dërguar lëndën në kompetencë të Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndërsa pas analizimit të shkresave të lëndës jashtë seancës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.1007/2021 të datës 03.08.2022 duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune në institucionin arsimor SHFMU “D.....”, në fshatin Zh....., Komuna e V..... sipas kontratave të punës, të lidhura me Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) në Vushtrri. Po ashtu, nuk është kontestuese fakti se paditësit në shkollën ku punojnë, nuk e kanë të rregulluar çështjen e ushqimit të të punësuarve përmes restorantit a kuzhinës ose në ndonjë formë tjetër. Siç rezulton nga provat në shkresat e lëndës, paditësit K.K dhe L.K e kanë arritur përvojën e punës mbi 10 vite ndërsa paditësi i tretë M.B e ka arritur përvojën e punës mbi 20 vite, e kjo vërtetohet në bazë të vërtetimeve të lëshuara mbi përvojën e tyre, nga shkolla ku punojnë, e të cilat gjinden në shkresat e lëndës, mirëpo që njëjtëve nuk u është paguar shpërblimi në emër të pagës jubilarë e as kompensimi për shujtat ditore për ditët e vijimit në punë, ashtu siç përcaktohet me nenin 35 par.7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017. Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson, se e paditura ka pasur detyrim që paditësve t`ua paguaj pagat jubilarë përkitazi me përvojën e punës, si dhe kompensimin për ushqim gjatë ditëve të punës, ngase me provat e deponuara siç janë: Kontrata e punës së paditësit K.K me nr...../32 i dt.28.09.2016, Kontrata e punës së paditësit L.K me nr..... e dt.26.09.2014 si dhe Kontrata e punës së paditësit M.B me nr..... e dt.26.09.2014, si dhe Vërtetimi mbi përvojën e punës dhe ditët e pranisë në punë për paditësin K.K, me nr....., i datës 15.10.2019, Vërtetimi mbi përvojën e punës dhe ditët e pranisë në punë për paditësin L.K, me nr....., i datës 15.10.2019, Vërtetimi mbi përvojën e punës dhe ditët e pranisë në punë për paditësin M.B, me nr....., i datës 15.10.2019 të lëshuar nga SHFMU “D.....”, në fshatin Zh....., Komuna e V....., vërtetohet se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se nga data 18.04.2017 deri me datë 16.06.2019, paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i kanë të realizuara gjithsej prej nga 411 ditë pune, e po ashtu nga këto vërtetime, vërtetohet se paditësi i parë K.K dhe paditësi i dytë L.K kanë gjithsej 13 vite përvojë pune, ndërsa paditësi i tretë M.B ka gjithsej 21 vite përvojë pune. Gjithashtu, nga lista e pagave është vërtetuar lartësia e pagave neto që realizojnë paditësit, ashtu që paditësi i parë K.K dhe paditësi i dytë L.K realizojnë paga mujore neto në shumë prej 448,98 €, ndërsa që paditësi i tretë M.B realizon pagë mujore prej 465,86 euro.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata ju ka referuar nenin 35 par.7 dhe 8 nën-paragrafi 8.1 dhe 8.2 të të Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 18.04.2017, ndërsa vendimin për kamatën e ka mbështetur në dispozitivin e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, kurse për shpenzimet e procedurës ka vendosur në kuptim të dispozitivit të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën e të paditurës brenda kufijve të saj, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m), si dhe për zbatimin e së drejtës materiale, konform nenit 194 të LPK-së, vjen në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat gjykata e shkallës së dytë i vëren sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera që pretendohet me ankesë, gjendja faktike është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, e drejta materiale është zbatuar drejtë sa i përket mënyrës së vendosjes për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe pagës jubilarë për paditësin M.B, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpërblimin jubilar për paditësit K.K dhe L.K dhe për këtë

pjesë është dashur që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se në rastin konkret lidhur me shpërblimin jubilar gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, meqenëse gjykata e shkallës së parë gabimisht i është referuar nenit 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 dhe po ashtu gabimisht ka interpretuar institutin e parashkrimit në këtë rast në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës. Nga provat e administruara konkretisht nga vërtetimet e të paditurës me nr.339 dhe nr.347 të datës 15.10.2019, vërtetohet se paditësit K.K dhe L.K kanë 13 vite përvojë pune duke krijuar marrëdhënie të punës që nga viti 01.09.2005, nga çka rezulton se vitin jubilar ose vitin e 10 të përvojës së punës si kusht për të kërkuar kompensimin e pagës jubilarë, e kanë arritur në vitin 2015, kur ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Arsimit e dt.01.01.2015 ndërsa padia e paditësve është paraqitur me datën 23.10.2019. Prandaj kërkesës së paditësve K.K dhe L.K për shpërblim jubilar, për të kërkuar një gjë të tillë, është dashur të refuzohet konform nenit 87 të Ligjit të Punës kërkesa e paditësve për shpërblim jubilar në shumë prej 224.49€ për secilin prej tyre.

Gjykata e Apelit e ka vërtetuar pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë si në pikën II të dispozitivit të saj lidhur me kompensimin e shujtave-ushqimit për ditët e pranisë në punë, sepse me dispozitën e nenit 35 par.7 të kësaj Kontratës Kolektive të Arsimit e cila ka hyrë në fuqi 18.04.2017, përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluara ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*, dhe pagës jubilarë për paditësin M.B për 20 vite të përvojës së punë në vlerë të 75% të pagës bazë duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 8 pika 8.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 ku nga vërtetimi i përvojës së punës të lëshuar nga e paditura me nr.342 të datës 15.10.2019 vërtetohet se i njëjti ka krijuar marrëdhënie të punës që nga data 01.09.1999 ndërsa vitin e 20 jubilar e ka arritur në vitin 2019 andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit për këtë pjesë, dhe për pjesën e shujtave ditore për secilin paditës pasi që u vërtetua që paditësit nuk e kanë realizuar të drejtën për ushqim gjatë pranisë në punë, konkretisht për 441 ditë, për periudhën 18.04.2017 deri me 16.06.2019, e drejtë kjo e cila buron nga kontrata kolektive e lartcekur.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve, duke e detyruar të paditurën që paditësve t'ua paguaj ushqimin – shujtat për ditët e pranisë në punë, me të drejtë është bazuar në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit e lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, (MASHT) dhe Sindikatës Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, (SBASHK), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, ndërsa paditësit e kanë kërkuar kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë për periudhën prej 18.04.2017 deri me dt.16.06.2019 që do të thotë për periudhën brenda kontratës, po ashtu kjo marrëveshje - kontratë ka qenë në fuqi në momentin e parashkrimit të padisë pra dt. 23.10.2019, dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës 03/L-212

i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se: Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*”.

Gjykata e Apelit vendosi sikur në pikën II të dispozitivit, duke e vërtetuar aktgjykimin e atakuar në pjesën me të cilin është vendosur lidhur me kompensimin e shpenzimeve për ushqimin në punë dhe pagës jubilarë, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me: dispozitën e nenit 67 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet. a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*”. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 4 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*”. Andaj duke iu referuar dispozitave të lartcekura pretendimet e të paditurës sa i përket asaj se e njëjta nuk është nënshkruese e kontratës dhe se e njëjta nuk është palë që ka marr obligime, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pathemelta.

Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9 “.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit M.B në emër të pagës jubilarë dhe në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë për të gjithë paditësit, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”.

Drejtë del të jetë vendosur edhe lidhur me kamatën e gjykuar, për faktin se e njëjta është gjykuar në përputhje të plotë me dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, e po ashtu edhe lidhur me shpenzimet e procedurës duke iu referuar nenit 452 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar dhe ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve sa i përket shpërblimit jubilar, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar për pjesën tjetër sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore, por të cilat nuk patën ndikim në vendosje ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lart, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika d) dhe e) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.6250/2022, me datë 22.10.2024

Kryetari i kolegjit  
Qerim Ademaj, d.v